

ANEKSI NR. 1 B KUSHTET E VEÇANTA TË SHËRBIMEVE DHE TARIFAVE

Në këtë Aneks, pasqyrohen shërbimet bazë dhe shtesë të ofruara nga ONE dhe të zgjedhura nga Pajtimtari, kushtet e veçanta, tarifat përkatëse të shërbimeve si dhe mënyra e tarifimit.

- Plani Tarifor HOMENET

	Plani HOMENET
Pajtimi Mujor	1,200 lekë/muaj
Internet 4G/4G+	200 GB

Klienti do të ketë mundësi të zgjedhë programin HOMENET vetëm ose të kombinuar me një nga programet me kontratë: ONE Unlimited dhe ULTRA Unlimited.

Ne mënyrë që klienti të përmirësojë shpejtësinë e internetit pasi të ketë konsumuar GB e vlefshme, të përfshira ne programin e përcaktuar më sipër, do t'i ofrohet mundësia e blerjes së paketave shtesë të internetit si më poshtë:

Cmimi I paketës	GB e përfshira	Vlefshmëria
300 Lekë	20GB	30 ditë
500 Leke	50GB	30 ditë

Shënime:

- 1) Të gjitha tarifat e mësipërme janë me TVSH të përfshirë.
- 2) GB e përfshira në program janë të vlefshme për një periudhë 1 mujore dhe nuk transferohen në muajt e ardhshëm.
- 3) Njësitë GB të mësipërme nuk janë të vlefshme për t'u përdorur në Roaming.
- 4) Përllogaritja e konsumit të internetit do të bëhet cdo 100 KB.
- 5) Pas konsumimit të GB të përfshira në paketë, klientët do të vazhdojnë lundrimin në internet por me shpejtësi të kufizuar (256 kbps).
- 6) Paketat shtesë të internetit do të kenë një vlefshmëri prej 30 ditësh
- 7) Plani HOMENET do të ofrohet me kontratë pajtimi me kohëzgjatje 12 mujore dhe kontratë pajtimi me kohëzgjatje 24 mujore.
- 8) PAGESA fikse mujore dhe GB e përfshira për muajin e parë të aktivizimit do të jetë proporcionale me ditët e mbetura të muajit të aktivizimit të kontratës. Vetëm në faturën e parë të lëshuar do të pasqyrohen deryrimi i muajit paraardhës (proporcional) dhe pagesa fikse mujore e muajit aktual.
- 9) PAGESAT fikse mujore në vijim do të aplikohen cdo datë 1 të muajit kalendarik. Në çdo faturë mujore të lëshuar në vijim, do të shfaqet vetëm vlera e pagesës mujore fikse e muajit aktual dhe paketat shtesë të aktivizuara në muajin e mëparshëm.
- 10) Kohëzgjatja minimale e kontratës është 12 muaj. Në rast të zgjidhjes së parakohshme të kontratës prej Pajtimtarit brenda afatit fillestar 12 mujor apo 24 mujor, Pajtimtari ka detyrim të paguajë si penalitet, vlerën e tarifës mujore fikse për të gjithë muajt e mbetur deri në përfundimin e afatit të kontratës 12 mujore ose 24 mujore.
- 11) Në rast kur pajtimtari ka përfituar nga një ofertë promovionale si psh zbritje në pajtimin mujor, sipas kushteve të ofertës promovionale, dhe vendos zgjidhje të parakohshme të kontratës, së bashku me detyrimet e përmendura më sipër duhet të paguajë edhe përfitimet nga oferta promovionale. (shumën e përfitimeve për të gjithë periudhën promovionale).
- 12) Për të përfituar nga ofertat promovionale të komunikuar nga ONE, pajtimtari duhet të shlyejë detyrimet sipas afatit të përcaktuar në faturë.
- 13) Në rast kur HomeNet ofrohet i kombinuar me plane të tjera tarifore me kontratë, dhe pajtimtari përfiton zbritje në pajtimin mujor apo rritje të benefiteve të HomeNet, përfitimet e HomeNet nuk do të jenë me të vlefshme nëse pajtimtari do të shkëpusë kontratën e planit tarifor të kombinuar me HomeNet.
- 14) Të gjitha pajisjet e dhëna Pajtimtarit nga ONE për ofrimin e shërbimit të internetit, janë pronë e ONE dhe i jepen në përdorim Pajtimtarit për të gjithë kohëzgjatjen e shërbimit. Pajtimtari detyrohet që në rastin e zgjidhjes ose përfundimit të kontratës të pajtimit, t'i kthejë ONE-t këto pajisje.
- 15) Me lidhjen e kontratës së pajtimit, Pajtimtari do të paguajë një shumë prej 2000 lekë, që do të shërbejë si garanci gjatë përdorimit të pajisjes prej tij. Kjo shumë do t'i kthehet Pajtimtarit pasi t'i ketë dorëzuar pajisjen në kuti së bashku me të gjithë aksesorët ONE-it dhe pasi kjo e fundit të ketë kryer verifikimin nëse pajisja funksionon rregullisht nga ana teknike. Në rast se Pajtimtari nuk i kthen ONE pajisjet e instaluar në kuti së bashku me të gjithë aksesorët, me zgjidhjen ose përfundimin e kontratës së pajtimit, ose kur konstatohet prej ONE se pajisjet e dhëna në përdorim pajtimtarit janë dëmtuar prej tij, atëherë Pajtimtarit nuk do t'i kthehet shuma prej 2000 lekë që ka paguar si garanci për këto pajisje.

- 16) Pajtimtari merr përsipër: (i) të përdorë pajisjet vetëm për qëllimin që i janë dhënë në përdorim kundrejt garancisë, nga ONE, duke respektuar të gjitha kushtet e përdorimit të pajisjeve si dhe do të sigurojë që pajisjet të funksionojnë brenda kushteve teknike të kërkuara; (ii) të ruajë pajisjet nga dëmtime të ndryshme që mund t'i ndodhin si pasojë e ndryshimeve në rrymën elektrike, nga dëmtime që mund t'i shkaktohen nga faktorë atmosferikë; (iii) si dhe të ruajë pajisjet nga ndërhyrje të paautorizuara të personave të tretë; në të kundërt Pajtimtari do të konsiderohet përgjegjës për dëmet e mundshme dhe si penalitet, nuk do t'i kthehet shuma prej 2000 lekë që ka paguar si garanci për këto pajisje.